



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 138 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 20/ 09 / 2023

VENDIM

Nr. 35, datë 20/09/2023

PËR

BUXHETIN E SHPENZIMEVE PËR AKTIVITETET DHE PAGAT E KKDM DHE STRUKTURAVE TË KTPD, SKDM, ITD GJATË VITIT 2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 20.09.2023 mori në shqyrtim Buxhetin e shpenzimeve të nevojshme për Aktivitetet dhe Pagat e KKDM dhe strukturave mbështetëse të këtij Institucioni (KTPD, SKDM, ITD) sipas kërkesave të legjislacionit të mësipërm në fuqi.

Gjatë mbledhjes u shqyrtuan dhe u diskutuan aktivitetet kryesore të KKDM dhe strukturave mbështetëse të tij për vitin 2024 si dhe detyrimet e përcaktuara në legjislacion për përfaqesimin e shtetit Shqiptar në Komisionin ndërkombëtar të digave të mëdha (ICOLD) dhe në aktivitetet e organizuara nga ky Komision.

Gjithashtu, Komiteti diskutoi edhe për aktivitetet kryesore të parashikuara të KKDM gjatë vitit 2024 për kontrollin 10 vjeçar të sigurisë së digave të mëdha sipas ligjit dhe prioritetëve të përcaktuara nga Komiteti, përgatitjen e standardave teknike në fushën e monitorimit të digave dhe masave antisizmike në këtë sektor, organizimin e trainimeve për shfrytëzuesit e digave në lidhje me Operimin dhe monitorimin e digave, promovimin e sektorit të sigurisë së digave, organizimin e aktiviteteve me rastin e 60 vjetorit të antarësimit të Shqipërisë në ICOLD, mbështetjen e përparimit teknik në fushën e sigurisë së digave, bashkëpunimit me organizata analoge Europiane, etj. Gjatë vitit 2024 janë parashikuar të organizohen konferenca të përbashkëta me Komitetin Kombëtar të digave dhe rezervuarave të Francës (CFBR) dhe Komiteteve analoge fqinjë, rrjetin European të Autoriteteve të Sigurisë së Digave si dhe aktivitete të ndryshme në lidhje me 60 vjetorin e antarësimit të Shqipërisë në ICOLD. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të miratoj Buxhetin për vitin 2024 të propozuar nga ekipi i punës për shpenzimet e domosdoshme për aktivitetet dhe pagat e KKDM dhe strukturave mbështetëse të tij (KTPD, SKDM, ITD) sipas tabelës bashkëlidhur këtij Vendimi.
- 2- Ti propozoj Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë (MIE) si dhe Këshillit të Ministrave miratimin e këtij buxheti i cili është i nevojshëm për plotësimin e detyrave të përcaktuara në ligj si dhe realizimin e aktiviteteve të parashikuara për vitin 2024 të dhëna me sipër. Buxheti do të jetë pjesë e buxhetit të MIE ose institucioneve të tjera të përcaktuara me ligj

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

